



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.18.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
PUNËVE TË JASHTME
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Fjolla Bakalli – Sadiku (udhëheqës i ekipit) si dhe Pleurat Isufi dhe Albana Kadriu-Zogjani (anëtar të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
5 Qeverisja e mirë.....	22
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	28
Shtojca III: Letërkonfirmimi	35

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2017, i cili e përcakton opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/11/ 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se MPJ në fund të vitit 2017 kishte një bilanc të shpenzimeve (avanceve) të pambyllura në MDK në vlerë prej 331,700€. Poashtu shënimet e paraqitura tek avancet e pa arsyetuara nuk ishin të sakta.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrisë në auditimin 2017**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ). Ne kemi analizuar veprimtarinë e MPJ-së, për të vlerësuar se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe vlerësimin e aranzhimeve të qeverisjes, deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF. Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për çështjet në vijim:

- MPJ në fund të vitit 2017 kishte një bilanc të shpenzimeve (avanceve) të pambyllura në MDK në vlerë prej 331,700€. Duke ju referuar shënimeve të bashkangjitura në PFV, ky bilanc për vitet paraprake ishte 211,107€, ndërsa për vitin aktual ishte 120,593€. Ky bilanc vjen si rezultat i thyerjeve midis hyrjeve dhe daljeve të paregjistruara në MDK, ku përfshihen shpenzime të paregjisturara, të hyra dhe rimbursime të paregjistruara, diferenca për shkak të kurseve të këmbimit, gabime në regjistrime etj. Pavarësisht angazhimeve për barazime financiare, MPJ kishte identifikuar disa nga shkaqet e kësaj gjendje të krijuar por akoma nuk ka arritur që të ketë një evidencë të plotë për këtë bilanc të pambyllur.
- Poashtu, në PFV tek “Neni 20–Avancet e pa-arsyetuara”, MPJ kishte paraqitur vlerën prej 576,593€, por nuk kishte dhënë shpjegime lidhur me këtë shumë. Vlera e paraqitur si avanc i paarsyetuar në fakt paraqet vlerën e zotimeve të hapura në fund të vitit 2017 për MDK, dhe kjo nuk është shpjeguar në PFV. Në vend të kësaj shume, është dashur të paraqitet vlera e saktë e avanceve të hapura. Opinioni jonë nuk është kualifikuar në lidhje me keto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Punëve të Jashtme është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MPJ kërkohet që të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr.03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimtimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin përfundimtar të prokurimit; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Përveç çështjeve të paraqitura të opinionit të auditimit, në PFV kemi identifikuar edhe disa gabime si më poshtë:

- Tek prezantimi i granteve të përcaktuara të donatorëve (*Neni 14 – Raporti i ekzekutimit të buxhetit*"/*Te "Hyrja e parasë së gatshme në llogari të thesarit"*), në kolonën e buxhetit final do të duhej të paraqitej vetëm vlera e donacioneve të vitit aktual ndërsa MPJ kishte përfshirë edhe vlerën e donacioneve të bartura nga viti paraparak duke mbivlerësuar buxhetin e donacioneve për 39,267€. Te e njëjta tabelë, tek daljet e parasë së gatshme, buxheti final për mallra dhe shërbime ishte nënvlerësuar për 70,654€, për shkak se pjesa e buxhetit nga donacionet e jashtme nuk ishte përfshirë.

-
- Tek Neni 19 “Raport për pasurinë jo financiare” MPJ kishte prezantuar pasuri kapitale në vlerë prej 2,866,246€. Kjo vlerë ishte në përputhje me regjistrin kontabël në datën e raportimit, mirëpo tabela e shpalosjeve detale të pasurisë kapitale (e bashkangjitur në PFV) nuk ishte në përputhje me këtë vlerë të raportuar. Sipas këtyre shpalosjeve vlera neto e pasurive kapitale figuronte 3,299,812€ pasi që në këtë vlerë nuk ishte paraqitur efekti i zhvlerësimit të pasurisë për vitin 2017.

Sa i përket kërkesave për raportim të jashtëm, MPJ ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore me përjashtim të barazimeve mujore me Thesar për të hyrat, ku MPJ kishte kryer vetëm barazime tremujore në mospërputhje me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat 03/2010.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

- Rekomandimi 1** Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë detale për t’i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Në këtë kontekst duhet të ndërmerren masa konkrete për t’i adresuar problemet lidhur me shpenzimet e paregjistruara që po përseriten vit pas viti. Po ashtu, duhet të bëhet prezantimi i saktë i avanceve të paarsyetuara.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të sigurojë se bëhet prezantimi i saktë i grantëve të donatorëve, si dhe të sigurojë që raporti i pasurive jofinanciare të jetë konsistent me shpalosjet. Gjithashtu, Ministri duhet të sigurojë që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet e identifikuar nga auditimi. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtijshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i pagave, menaxhimi i shpenzimeve në Misione Diplommatike dhe Konsullore, realizimi i buxhetit dhe prokurimi. Po ashtu edhe menaxhimi i pasurisë dhe raportimi i obligimeve të papaguara duhet të përmirësohen. Kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme por ende ka vonesa të theksuara në regjistrim të cilat duhet të evitohen.

Edhe më tutje çështja më sfiduese mbetet trajtimi dhe identifikimi i shpenzimeve të pambyllura nga vitet paraprake. Këtë vit nuk ishte mbyllur pothuajse asnjë shpenzim që i përket periudhave të kaluara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	20,959,053	22,733,193	20,430,293	19,213,681	18,243,748
Granti i Qeverisë -Buxheti	20,959,053	22,662,539	20,410,343	19,183,401	18,200,658
Donacionet e jashtme		70,654	19,950	30,280	43,090

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,774,140€. Kjo rritje ishte rezultat i donacioneve të jashtme si dhe rritjes së aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Në vitin 2017, MPJ ka shpenzuar 90% të buxhetit final ose 20,430,293€. Ky realizim krahasuar me vitin 2016 është për 6% më i ulët. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	20,959,053.00	22,733,193	20,430,293	19,213,681	18,243,748
Pagat dhe Mëditjet	5,560,891	6,432,342	6,432,342	5,759,871	5,046,204
Mallrat dhe Shërbimet	12,703,547	15,389,865 ²	13,268,981	12,088,464	12,446,918
Shërbimet komunale	538,051	687,084	521,719	380,578	354,966
Subvencionet dhe Transferet	100,000	50,000	33,450	364,470	98,029
Investimet Kapitale	2,056,564	173,903	173,801	620,298	297,631

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga, krahasuar me atë fillestar ishte rritur për 871,451€ si rezultat i mungesës së mjeteve për MDK. Kjo rritje ishte me rishikim të buxhetit në vlerën prej 287,527€, ndërsa me vendim të Qeverisë kishte pasur një tjetër rritje prej 583,924€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 2,686,318€. Kjo rritje ishte me rishikim të buxhetit 1,500,000€, me vendime të Qeverisë 907,097€, fondet e pranuar nga donatorët e jashtëm në vlerë prej 70,654€, si dhe 208,567€ ishin transferuar nga kategoria e investimeve kapitale, subvencioneve dhe transfere dhe komunalive. Kjo rritje ishte rezultat i mungesës së mjeteve për MDK. Përkundër kërkesës për rritje të buxhetit, realizimi i buxhetit ishte 86%;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte rritur për 149,033€. Ky ndryshim ishte rezultat i rishikimit buxhetor me të cilin buxheti ishte rritur për 50,000€ si dhe vendimit të qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 115,000€. Më vonë me vendim qeveritar nga kjo kategori ishin transferuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve mjete në vlerë 15,967€;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte përgjysmuar në raport me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim kishte ndodhur me vendim të Qeverisë. Këto mjete ishin transferuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Edhe përkundër këtij zvoglumi, realizimi nuk ishte në nivel të kënaqshëm (67%); dhe
- Buxhetit final për investime kapitale ishte zvogëluar me një nivel mbi 90% në raport me buxhetin fillestar duke u reduktuar në vlerën prej 173,801€ si rezultat i procesit të rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final ishte 100%.

² Diferenca me shënimet në PFV ka të bëjë e donacionet që nuk janë përfshirë në buxhetin final (shih nënkapitullin 2.2)

Çështja 3 – Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

E gjetura Realizimi i buxhetit për investimet kapitale mbetet çështje sfiduese për MPJ-në. Edhe pse shpenzimi i vitit në raport me buxhetin final ishte 100%, nuk mund të themi se është tregues i performancës së mirë nëse krahasohet me buxhetin fillestar ku realizimi është vetëm 8%. Sipas buxhetit fillestar, 10 projekte kapitale kishin qenë të planifikuara për këtë kategori dhe si rezultat i mungesës së kërkesave për inicim nga njësitë kërkuese, vonesave dhe mos-realizimit të projekteve në përputhje me planin e prokurimit, për pesë projekte ishin tërhequr të gjitha mjetet dhe një projekt kishte reduktim të mjeteve 80%, me proces të rishikimit buxhetor.

Si rezultat i planifikimit jo të mirë buxhetor, realizimi nuk ishte i kënaqshëm as tek subvencionet & transferet ku niveli i ekzekutimit në raport me buxhetin final ishte vetëm 67%. Kjo paraqet një performancë jo të kënaqshme sidomos nëse bëhet krahasimi me buxhetin fillestar i cili ishte përgjysmuar.

Rreziku Planifikimi dhe realizimi i dobët i buxhetit rezulton me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion, si dhe reduktion efektivitetin e planeve të shpenzimeve të organizatës buxhetore. Mos-përmbushja e projekteve të planifikuara rezulton me më pak projekte të realizuara, mos arritje të objektivave të Ministrisë dhe në reduktim potencial të buxhetit për vitet e ardhshme.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të ndërmerr një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të realizimit të buxhetit për investime kapitale dhe fushave tjera të shpenzimeve për vitin 2017 dhe më herët, dhe të përcaktoj alternativa praktike për përmirësimin e realizimit të tij.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPJ në vitin 2017 ishin në vlerë 3,153,732€. Ato kanë të bëjnë me taksat për dokument të udhëtimit, për verifikim të dokumenteve, për letërnjoftim, për shtetësi, për vulë apostile etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Planifikimi	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	-	3,153,732	2,546,086	1,838,477

Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton një trend në rritje krahasuar me vitet paraprake. Kjo rritje është kryesisht rezultat i realizimit të të hyrave nga lëshimi i vulave apostile që ka filluar të aplikohet në vitin 2017 si dhe rritjes së të hyrave nga taksat për dokumente të udhëtimit.

Çështja 4 - Mungesë e planifikimit dhe vonesa në regjistrimin e të hyrave

- E gjetura** Edhe pse MPJ realizon të hyra, nuk bëhet ndonjë parashikim i vlerës së të hyrave që do të inkasohet përgjatë vitit. Përveç kësaj testimi ynë ka rezultuar me vonesa në regjistrimin e të hyrave të cilat ishin prej një deri në tre muaj. Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe në vitet paraprake por ende nuk janë marr masa në këtë drejtim.
- Rreziku** Mungesa e planit për të hyrat e pamundëson matjen e performancës në realizimin e të hyrave. Vonesat në regjistrim ndikojnë në raportim dhe pamundësojnë kryerjen e barazimeve mujore me Thesarin. Kjo rrit rrezikun e mos përfshirjes së tyre në PFV në fund të vitit.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj që personat përgjegjës të bëjnë planifikimin/parashikimin e të hyrave dhe të rris nivelin e përgjegjësisë nga shefat e misionëve diplomatike për të shmangur vonesat dhe të sigurojë që të gjitha të hyrat regjistrohen me kohë në SIMFK.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MPJ-së, e të cilat ndërlidhen me përcaktimin e koeficientëve të pagave, avancimin dhe aprovimin e shtesave etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti final për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 6,432,342€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 6,432,342€ apo 100%. Numri i planifikuar i stafit ishte 295 ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit 2017 ishte 293.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjet në vijim:

Çështja 5 - Mangësi në dosjet e personelit

- E gjetura** Në dy raste të testuara, në dosje të të punësuarve diplomatik, vendimet për emërim në pozita të caktuara ishin kopje të palexueshme. Departamenti i Burimeve Njerëzore nuk posedonte dokument tjetër valid për të punësuarit. Si rrjedhojë testimi ishte i pamundur pasi që nuk kishte dëshmi në dispozicion për të justifikuar pagën/shtesat e të punësuarve.
- Rreziku** Mungesa e dokumenteve origjinale në dosje të personelit dhe realizimi i pagesave përkundër mungesës së tyre, rrit rrezikun që të ndodhin pagesa të parregullta.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës i dosjeve të personelit, për të siguruar se ato mbahen dhe azhurnohen në pajtim me kërkesat ligjore.

Çështja 6 - Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre

- E gjetura** Rregullorja nr.06/2010 për procedurat e emërimit në shërbimin civil përcakton se asnjë pozitë e lartë drejtuese nuk mund të mbahet me ushtrues detyre më tepër se tre muaj. Në MPJ deri në fund të vitit 2017, tri pozita udhëheqëse mbaheshin me ushtrues detyre duke tejkalluar limitin e lejuar ligjor për mbajtjen e pozitës në këtë formë. Një nga ta është caktuar UD në vitin 2016 dhe dy të tjerët në muajt prill dhe maj 2017. Të njëjtët vazhdojnë ti mbajnë pozitën si UD deri në fund të auditimit për vitin 2017 (prill 2018).
- Rreziku** Mbajtja e pozitave të punës me ushtrues detyre në periudha të gjata kohore duke i tejkalluar afatet e përcaktuara ligjore ndikon në cilësinë e performancës operationale të zyrtarëve dhe rrjedhimisht edhe të ministrisë.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 16,076,949€, prej tyre ishin shpenzuar 13,790,700€. Këto shpenzime përfshijnë: furnizime për zyre, shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, shpenzime të qirasë për ndërtesa, shërbime kontraktuese tjera, shërbime për sigurime shëndetësore të stafit, dreka zyrtare etj. Testimet tona bërë kësaj fushe të shpenzimeve kanë rezultuar me të gjeturat në vazhdim:

Çështja 7 – Tejkallim i shpenzimeve të lejuara të qirasë për personelin e MDK-ve

- E gjetura** MPJ, paguan qiratë për personelin në misionet diplomatike dhe konsullore në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2012. Në katër misione (Londër, Tokio, Romë dhe Milano) kemi gjetur se ka tejkallim të shpenzimeve të lejuara të qirasë mujore nga 50€ deri në 1,600€. Këto tejkallime kryesisht kanë të bëjnë me qiratë e Ambasadorëve dhe stafit konsullor në misionet e lartëcekura. Nga mostrat e testuara vlera e tejkallimeve ishte rreth 14,700€.
- Rreziku** Tejkallimi i shumës së shpenzimeve të lejuara për qira ashtu siç është paraparë në UA dëmton buxhetin si dhe paraqet rrezik që MPJ të mos jetë në gjendje t'i mbulojë këto shpenzime si pasojë e tejkallimit të planifikimeve buxhetore të ndara për këtë kategori.
- Rekomandimi 7** Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së duhet të sigurojnë që pagesa e qirasë të bëhet në përputhje me Udhëzimet në fuqi, në mënyrë që mos të ketë tejkallime të shpenzimeve të lejuara.

Çështja 8 – Vonesa në regjistrimin e shpenzimeve

- E gjetura** UA nr. 03/2012 i obligon Misionet Diplomatike dhe Konsullore (MDK), që deri me datën 15 të muajit pasues të dërgojnë raport të shpenzimeve në departamentin e financave në MPJ, për t'i regjistruar në SIMFK. Në 16 raste, kishte pasur vonesa në regjistrimin e shpenzimeve prej një deri në 10 muaj.
- Rreziku** Vonesat në regjistrimin e shpenzimeve ndikojnë që raportimet gjatë tremujorëve të jenë të pasakta, pasi ato nuk e tregojnë vlerën e saktë të shpenzimeve të ndodhura. Kjo rrit rrezikun që ato të mos përfshihen edhe në PFV.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë zbatimin e plotë të dispozitave ligjore në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve, për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e tyre nga zyrtarët kompetent. Raportimet periodike përfshirë pasqyrat financiare, duhet të përmbajnë informata të sakta për transaksionet financiare.

Çështja 9 – Ndarje jo e duhur e detyrave në procesin e prokurimit

- E gjetura** Kryetari i komisionit për vlerësimin e ofertave të tenderit “Shërbimet e përkthimit për nevojat e MPJ-së”, ishte caktuar edhe menaxher projekti për këtë kontratë. Kjo është në kundërshtim me Rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimin publik.
- Rreziku** Ndarja jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësive, respektivisht angazhimi i zyrtarëve të njëjtë në vlerësimin e ofertave dhe në menaxhimin e projektit është në kundërshtim me rregullat e aplikueshme dhe rrit rrezikun e konfliktit të interesit.
- Rekomandimi 9** Ministri duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës ti zbatojnë kërkesat e rregullave të aplikueshme, në aktivitetet e prokurimit, në mënyrë që të shmangët mundësia e konfliktit të interesit.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 50,000€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 33,450€ apo 67% e buxhetit final. Projektet e subvencionuara kryesisht kishin të bënin me përkrahjen e panairit "Ditët e Prodhimeve të Kosovës", përkrahje financiare për nëpunësin e MPJ-së me rastin e komplikimeve shëndetësore, subvencione për bashkëpunim me Aleancën Franceze etj.

Çështja 10 – Dobësi në arsyetimin e projekteve të subvencionuara

- E gjetura** MPJ kishte bashkëfinancuar organizimin e panairit “Ditët e Prodhimeve të Kosovës” në Kroaci, në vlerë 3,850€. Sipas marrëveshjes, përfituesi i subvencionit ishte i obliguar që pas përfundimit të aktiviteteve, të përgatis raport pune për Ministrinë, të shoqëruar me dëshmitë financiare përkatësisht me faturat për shpenzimet e bëra. Përfituesi kishte sjellë një raport pune, dhe kishte lëshuar një faturë, mirëpo nuk janë bashkangjitur faturat origjinale për shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet tjera që janë mbuluar nga MPJ.
- Rreziku** Mungesa e dëshmive financiare (faturave) për projektet e subvencionuara rrit rrezikun që mjetet të shfrytëzohen për qëllime tjera nga ato të synuarat.
- Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë, që çdo përfitues i subvencioneve të raportoj për shpenzimet e bëra ashtu siç parashihet me Marrëveshjet e Bashkëpunimit, me qëllim që të sigurohet se mjetet po shpenzohen në përputhje me qëllimin e destinuar.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 173,903€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 173,801€. Shpenzimet e realizuara kanë të bëjnë me blerjen e veturave zyrtare për Ambasada si dhe blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative të tilla si kompjuterë, llap-top, makina fotokopjuese etj.

Çështja 11 - Mangësi në vlerësimin e tenderit

E gjetura Në procedurën e prokurimit “Mirëmbajtja e sistemit të vizave” (vlera e kontratës 191,160€), në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional në dosje të tenderit, ishte kërkuar që stafi i përfshirë në projekt (Udhëheqësi i Projektit dhe Ekspertët) të dëshmojnë përvojën e punës me referenca nga klienti në së paku dy projekte. OE fitues kishte siguruar vetëm listën e projekteve të realizuara nga stafi i tij, por jo referencat nga klientët siç ishte kërkuar në dosje të tenderit.

Rreziku Mos-përfillja e kërkesave të dosjes së tenderit është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe mund të rezultoj me përzgjedhje të ofertuesve të pa përgjegjshëm, shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të tenderuesve dhe vlerë të dobët për para në praktikën e prokurimit.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të sigurojë zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi në proceset e prokurimit dhe respektimin e kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

MPJ kishte prezantuar në PFV pasuri kapitale (mbi 1,000€) në vlerë neto 2,866,246 € dhe pasuri jo kapitale (nën 1,000€) në vlerë 1,014,964€. Pasuria nën 1,000 euro evidentohet në regjistra të brendshëm të MPJ-së, dhe shënimet nga këto regjistra raportohen në PFV, kjo pasiqë sistemi e-pasuria nuk ka arritur të funksionalizohet plotësisht, për shkak se pasuritë e MDK-ve nuk evidentohen në e-pasuria.

Ne kemi testuar blerjet e vitit duke përfshirë investimet kapitale dhe blerjet për pajisje dhe mobilje nën 1,000€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe rregullsinë në evidentimin dhe inventarizimin e pasurisë në dispozicion. Testimet tona kanë rezultuar me mangësitë e mëposhtme:

Çështja 12 - Nënvlërim i gjendjes së pasurisë

E gjetura MPJ nuk kishte arritur akoma të siguroj regjistrim të plotë dhe prezantim të saktë të gjendjes së pasurisë kapitale dhe inventarit në regjistra dhe në PFV. Kjo pasi ne kemi identifikuar pasuri të paregjistruara dhe gabime në regjistrimin e pasurive:

- Pasuria e paprekshme (softuer) në vlerë prej 128,532€ të projektit “Krijimi dhe vendosja e sistemit të vizave” e cila është marrë si donacion, në mungesë të dokumentacionit të pranimit, ende nuk ishte regjistruar në SIMFK. Për këtë çështje ne kemi rekomanduar edhe në vitet paraprake por nuk është adresuar;
- 57 kompjuterë dhe tetë makina fotokopjuese të blera në vitin 2017 në vlerë prej 78,502€, ishin regjistruar në Regjistrin kontabël – SIMFK me çmimin e blerjes pa TVSH. Si rrjedhojë vlera e tyre ishte nënvlëruar për 7,083€;
- Sipas UA 06/2012 për regjistrimin e pasurisë në Misionë Diplomatike Konsullore, pasuria e blerë në MDK duhet të raportohet nga Zyrtari i pasurisë së MDK-së tek Zyrtari i Pasurisë në MPJ. Ne kemi vërejtur se pesë MDK³ nuk i kishin raportuar fare pasuritë për vitin 2017. Si rrjedhojë informatat e prezantuara rreth pasurisë së përgjithshme të Ministrisë nuk prezantojnë gjendjen reale.

Rreziku Mos regjistrimi dhe mos raportimi i plotë i pasurisë në regjistra paraqet nënvlërim të gjendjes reale të pasurisë së ministrisë. Dobësitë në menaxhim dhe raportim me theks të veçantë në MDK, pengojnë menaxhimin efektiv dhe rrisin rrezikun e humbjes dhe tjetërsimit të pasurisë në mungesë të mekanizmave të kontrollit.

Rekomandimi 12 Ministri nëpërmjet personave përgjegjës, duhet të sigurojë funksionimin e mekanizmave të kontrollit në fushën e menaxhimit të pasurive, për të siguruar se pasuritë menaxhohen në pajtim me rregullat dhe regjistrat e pasurive të përmbajnë informatat e sakta dhe të plota për pasuritë në dispozicion të ministrisë. Informatat e njëjta duhet të barten edhe në PFV, për të shmangur mundësinë e modifikimit të opinionit të auditimit apo theksimin e çështjes.

³ Ambasada Tiranë; Konsulata Frankfurt; Konsulata Cyrih; Ambasada Beograd dhe Konsulata Iowa - SHBA

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 385,622€. Krahasuar me vitin 2016 kemi një rritje të obligimeve për 337,936€ (2016-47,686€). Kjo rritje ishte si rezultat i mungesës së mjeteve në kode të caktuara ekonomike (për shkak të zbatimit të pesë shifrorit) dhe se dy faturave që janë pranuar në fund të dhjetorit, njëra me vlerë 150,000€ për furnizim me server dhe pajisje tjera si dhe fatura tjetër 65,000€, për shërbime konsulente ndërkombëtare. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018 dhe paraqesin një pjesë të sfidave buxhetore me të cilat do të përballet Ministria.

Çështja 13 - Mangësi në raportimin e obligimeve

Rreziku Sipas Rregullës Financiare 01-2013 - Shpenzimi i parave publike, OB obligohet që çdo faturë të pranuar, të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditëve kalendrike nga data e pranimit të faturës. Ne kemi vërejtur fatura të biletave të udhëtimeve me aeroplan që i takonin Kabinetit të Ministrisë, të cilat ishin paguar me tre deri në nëntë muaj vonesë. Vlera e këtyre faturave ishte 127,628€ dhe i takonin vitit 2016, derisa janë paguar në vitin 2017. Këto fatura nuk ishin raportuara si obligime në PVF-të e vitit 2016.

Rreziku Mos pagesa në kohë e borxheve mund të rezultojë me ndëshkime ndaj ministrisë, ndërsa raportimi i mangët i obligimeve pamundëson planifikimin afatshkurtër të tyre.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve përgjatë procesit të pranimit dhe procedimit për pagesë të faturave, për të shmangur vonesat në kryerjen e obligimeve. Obligimet e mbetura në fundvit duhet të raportohen saktë në PFV, për të përmbushur kërkesat ligjore dhe për të shmangur modifikimin potencial të opinionit apo theksimin e çështjes në lidhje me PFV-të.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 kishte rezultuar në 14 rekomandime. MPJ kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do t'i zbatohen rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tri rekomandime të vitit 2016 ishin zbatuar, një rekomandim ishte në proces të zbatimit dhe 10 tjera nuk ishin adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 16 rekomandime (tetë të pa zbatuara dhe tetë të tjera që ishin në zbatim e sipër). Këto rekomandime deri në fund të auditimit tonë kishin mbetur në pothuajse të njejtin nivel të adresimit ku vetëm dy rekomandime ishin zbatuar, pesë të tjera ishin në proces të zbatimit dhe nëntë rekomandime nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 14 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura nga vitet e më herëshme janë zbatuar. Kjo për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së monitorimit formal i zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Ne nuk kemi vërejtur se MPJ aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve. Si rrjedhojë kemi çështje të përsëritura edhe këtë vit.
- Rreziku** Vonesat në zbatimin e rekomandimeve mund të rezultojnë me dobësi të vazhdueshme, mungesë të efikasitetit dhe me humbje potenciale financiare.
- Rekomandimi 14** Ministri duhet të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, të monitorohet në vazhdimësi dhe për progresin e arritur të raportohet në baza tremujore nga stafi përgjegjës.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse MPJ ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Edhe përkundër iniciativës për krijimin e grupit punues, MPJ ende nuk kishte arritur të hartoj një plan strategjik gjithëpërfshirës institucional që do të definonte objektivat kyçe dhe do të mundësonte monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të pritura. Në mungesë të dokumentit strategjik nuk ka arritur të vihet në funksion as një proces i mirëfilltë për menaxhimin e rreziqeve që ndërlidhen me përmbushjen e objektivave strategjike. Kjo situatë ishte reflektuar në pyetësinë e vetëvlerësimit të dërguar në Ministrinë e Financave.

Poashtu fushë që kërkon zhvillim të mëtutjeshëm mbetet përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit si dhe planifikimi dhe menaxhimi efikas i buxhetit në MPJ dhe në Misionet Diplomatike Konsullore. Procesi i barazimeve financiare me MDK-të kërkon zhvillim të mëtutjeshëm me qëllim që të sigurohen evidenca të sakta si dhe më pas të merren masa adekuate për evitimin e parregullsive aktuale.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NjAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë disa fusha rishikimi për vitin 2017. Ky plan përfshinte gjashtë auditime të rregullta. Deri në fund të vitit 2017 plani ishte përmbushur në tërësi.

Komiteti i auditimit (KA), kishte mbajtur tri takime gjatë vitit 2017 ku ishin shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

MPJ ka vendosur një sistem relativisht funksional të kontrolleve të brendshme që përfshin ndarjen dhe delegimin e përgjegjësive, raportimin e rregullt tek menaxhmenti, për të mundësuar një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara. Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ende nevojiten masa të shtuara dhe mekanizma të reja kontrolli në raport me adresimin e çështjeve të identifikuara që lidhen me Misionet Diplommatike dhe Konsullore.

Po ashtu, mbetet ti kushtohet më shumë fokus hartimit të procedurave formale për menaxhim të rrezikut në nivel institucional në përputhje me udhëzimet e MFK-së për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 15 - Mandati i përfaqësuesve diplomatik

E gjetura

Sipas nenit 22 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhë katër vjeçare, ose ndryshe siç kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme. Në bazë të mostrave të testuara ne kemi vërejtur se në gjashtë raste, përfaqësuesit diplomatik kanë vazhduar ti mbajnë pozitat e njëjta pas skadimit të mandatit ligjor, edhe pse nuk kishte ndonjë vendim apo shkresë për vazhdimin e mandatit. Prej këtyre në tri raste nuk ishin bërë dekretet për kthim, edhe pse përfaqësuesve u kishte skaduar mandati, dy raste ku ishin bërë dekretet për kthim por përfaqësuesit nuk ishin kthyer, dhe një rast kur ishte bërë edhe dekreti për kthim edhe vendimi për tërheqje nga detyra, por ambasadori nuk ishte ri-sistemuar pas kthimit dhe kishte marrë pagë sipas gradës së ambasadorit për një periudhë tre mujore. Këto kanë ndodhur si pasojë e mangësisë së legjislacionit sekondar apo procedurave adekuate të përfundimit të mandatit dhe risistemimit të përfaqësuesve diplomatik.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, menaxhmenti i MPJ-së kishte reflektuar mbi situatën e krijuar duke marrë masa për ndërprerjen e ushtrimit të pozitave përtej afatit të përcaktuar ligjor. Këto masa pritet të aplikohen në tërësi gjatë vitit 2018.

Rreziku

Mbajtja e pozitave përtej afateve të përcaktuara ligjore, në mungesë të vendimeve për vazhdimin e tyre, mund të ndikoj që shteti të përfaqësohet nga persona juridikisht të pa autorizuar. Kjo mund të ndikojë edhe në performancën e shërbimit diplomatik si dhe në reputacionin e shtetit.

Rekomandimi 15

Ministri duhet inicojë rishikimin e legjislacionit sekondar në lidhje me shërbimin e jashtëm në mënyrë që të qartësohet saktë procedura e përfundimit të mandatit të përfaqësuesve diplomatik, përfshirë periudhat kohore të nevojshme dhe çështjet relevante për tërheqjen/ri-sistemimin e stafit diplomatik. Në rastet kur paraqitet nevoja për zgjatjen e mandatit të përfaqësuesve të caktuar diplomatik, kjo duhet të bëhet me vendim apo shkresë nga Ministri, konform Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.

Çështja 16 - Dobësi në menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, MPJ duhet të ketë një regjistër të rreziqeve që ndërlidhet me objektivat strategjike institucionale. MPJ nuk e kishte hartuar një regjistër të tillë gjatë vitit 2017. Megjithatë pas pranimit të memorandumit të auditimit të përkohshëm MPJ e ka hartuar regjistrin e rreziqeve për vitin 2018.
- Rreziku** Mungesa e procedurave për menaxhimin e rreziqeve mund të dobësoj performancën e organizatës, nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 16** Ministri duhet të sigurojë vendosjen e procedurave formale për menaxhimin e rreziqeve, në pajtim me kërkesat e MFK-së. Regjistri i rreziqeve duhet të monitorohet dhe azhurnohet në baza të rregullta kohore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Pasqyrat Financiare	Ministri duhet t'i kushtoj rëndësi të veçantë procesit të barazimit në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve dhe duhet që këtë proces ta monitorojë dhe shtyjë përpara për të përfunduar sa më parë. Ne inkurajojmë menaxhmentin për diskutimin me MF për mbylljen e këtij procesi që do të reflektojë edhe në buxhetin e MPJ-së për vitet në vijim.			Nuk është zbatuar. Këtë vit nuk ishte mbyllur pothuajse asnjë shpenzim i periudhave paraprake si dhe kishte edhe shpenzime të pambyllura të vitit.
Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë që përgatitja e PVF-ve për vitin 2016 të përfshijë rishikimin e hollësishëm të draft pasqyrave nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në harmonizimin e shënimeve dhe në fushat që konsiderohen që janë të rrezikut të lartë. Deklarata e nënshkruar nga ZKA dhe ZKF nuk duhet vendosur derisa kontrollet e nevojshme janë aplikuar.		Në proces të zbatimit. Përsëri nuk ishin regjistruar softuerët në regjistrin e pasurisë.	
Te hyrat	Ministri duhet të sigurojë se kontrollet janë efektive dhe kërkesat e raportimit të jashtëm në lidhje me të hyrat (barazimi me Thesar) realizohet çdo muaj siç e parasheh rregullorja financiare për të hyrat.			Nuk është zbatuar. Barazimet nuk kryhen në baza mujore por tre mujore.
Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pa adresuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet dhe ne presim që të ketë një progres mbi këtë.		Në proces të zbatimit	

Lista kontrolluese e vet-vlerësimit	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.			Nuk është zbatuar. Nuk ishte hartuar strategjia gjithëpërfshirëse institucionale.
Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë përmes sekretarit të përgjithshëm se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut te një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar se si rreziqet janë duke u menaxhuar.			Nuk është zbatuar. Nuk ishte hartuar regjistri i rreziqeve.
Auditimi i brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se ekziston një komunikim i mirë në mes menaxhmentit, komitetit të auditimit dhe NjAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme, dhe auditimet të orientohen në fushat ku rreziku nga mangësitë është më i madh. Po ashtu duhet të ndërmerren veprime që rekomandimet e AB të gjejnë zbatim në praktikë, e këtu një rol kyç e ka komiteti i auditimit në monitorimin dhe shtyrjen e këtij procesi.		Në proces të zbatimit. Është rritur niveli i rekomandimeve të zbatuara krahasuar me vitet paraprake duke ju referuar raportit vjetor për NjQHAB.	
Monitorimi i projektit	Ministri duhet të sigurohet para se të kryhen pagesat e mbetura, nëse projekti ishte realizuar në përputhje të plotë me marrëveshjen. Kjo mund të bëhet duke formuar një komision të përbërë nga stafi profesional, i cili do të verifikonte shkallën e realizimit të projektit, dhe pas pranimit të raportit të komisionit të vazhdohet me pagesën e obligimeve të mbetura.	Nuk ka pasur pagesa nga ky projekt këtë vit.		

Misionet Diplomatike	Ministri duhet të sigurojë te MDK-të që kanë valutë jo Euro që çështja e kursit të këmbimit të aplikohet sipas një kriteri dhe regjistrimi i shpenzimeve dhe të hyrave të jetë i barazuar plotësisht. Kjo do të ndikonte që shpenzimet dhe të hyrat të jenë reale dhe të mos ketë mbivlerësim dhe as nënvlerësim.		Në proces të zbatimit. MPJ kishte bërë përpjekje që sa më shumë të i përafrojë regjistrimet me MDK të cilat kanë valutë jo-Euro.	
Misionet Diplomatike	Ministri duhet të sigurojë se janë shtuar masat e kontrolleve për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e shpenzimeve nga zyrtarët e shpenzimeve në ministri. Në rastet kur ka diferenca të shpenzimeve të cilat sipas zyrtarëve nuk mund të regjistrohen, atëherë duhet të kërkohen dokumente apo sqarime shtesë nga MDK-të përkatëse.			Nuk është zbatuar. Përsëri ka vonesa të theksuara në regjistrim të shpenzimeve.
Paga dhe mëditje	Ministri duhet të sigurojë se kriteret specifike për gradime dhe emërime të nëpunësve për shërbimin e jashtëm aplikohen në të gjitha rastet. Po ashtu, duhet të sigurojë respektimin e afatit për kontratat mbi vepër si dhe për u.d. siç e parasheh legjislacioni duke siguruar rekrutim të stafit me kohë.		Në proces të zbatimit. Janë marr masa sa i përket marrëveshjeve për shërbime të veçanta por jo edhe për pozitat e mbajtura me Ushtrues Detyre.	
Subvencione dhe transfere	Ministri duhet të sigurojë se dhënia e subvencioneve monitorohet përmes raporteve narrative dhe financiare, në mënyrë që menaxhmenti të sigurohet që mjetet janë shpenzuar sipas kërkesës së paraqitur në projekt propozim.			Nuk është zbatuar. Edhe këtë vit është identifikuar një rast.
Te hyrat	Ministri duhet të rrisë nivelin e përgjegjësisë nga shefat e misioneve diplomatike për të shmangur vonesat dhe të sigurojë që të gjitha të hyrat raportohen dhe regjistrohen me kohë në SIMFK.			Nuk është zbatuar. Përsëri kishte vonesa në regjistrimin e të hyrave deri në tre muaj.

Pasuritë	Ministri duhet të shtoj kontrollin në menaxhimin e pasurive duke siguruar regjistrim dhe raportim të saktë, të plotë si dhe me kohë të vlerës së pasurisë që disponon MPJ. Po ashtu, inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë të bëhet në pajtim të plotë me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 02/2013.			Nuk është zbatuar. Nuk ishin regjistruar softuerët që kanë qenë rekomandim nga viti paraprak si dhe janë identifikuar disa pasuri të paregjistruara dhe gabime në regjistrim.
Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që ZKA ka ndërmarr veprimet efektive për të forcuar kontrollin në menaxhimin e depos dhe automjeteve. Çdo artikull duhet të pranohet nga zyrtari i pranimit (depoisti) ose komisioni i pranimit në rastet e caktuara. Po ashtu, Ministri duhet të sigurojë se janë aplikuar kontrolle efektive për të parandaluar përdorimin e automjeteve jashtë orarit pa aprovimin paraprak. Kjo do të ndikojë në përdorimin e rregullt dhe efikas të automjeteve	Këtë vit nuk kemi hasur raste të pranimit të pasurisë pa komision pranues.		
Obligimet	Ministri duhet të sigurojë se është vendosur një sistem efikas ku faturat pranohen dhe evidentohen në një vend dhe pastaj bëhet shpërndarja për zyrtarët përkatës. Kjo praktikë do të mundësojë që raportimi i obligimeve të jetë i saktë dhe i plotë dhe jep informata të plota për menaxhmentin dhe palët tjera për obligimet aktuale. Po ashtu në raportimet mujore duhet të përcjellët kronologjia e faturave të papaguara në mënyrë që faturat e papaguara të raportohen deri sa të paguhen dhe që menaxhmenti dhe Thesari të kenë informacionin e saktë për obligimet e mbetura.			Nuk është zbatuar. Kemi identifikuar obligime të pa raportuara.

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare	Ministri duhet të sigurojë se janë marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në Theksimin e Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar problemet lidhur me shpenzimet e paaprovuara të bartura nga vitet e kaluara, të cilat janë duke shkaktuar problem sistematik për MPJ-në;			Nuk është zbatuar. Këtë vit nuk ishte mbyllur pothuajse asnjë shpenzim i periudhave paraprake si dhe kishte edhe shpenzime të pambyllura të vitit.
	Ministri duhet të forcojë kontrollet lidhur me obligimet ligjore për raportimin e të hyrave dhe barazimin mujor të tyre me thesarin me qëllim që të plotësohen kërkesat statutore.			Nuk është zbatuar. Barazimet nuk kryhen në baza mujore por tre mujore.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara.		Në proces të zbatimit	
2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është kuptuar qartë rëndësia e hartimit të strategjisë së organizatës, si dhe hartimi i regjistrit të rrezikut nga personat e kyçur në proces. Në këtë mënyrë MPJ do të mund të monitorojë dhe të ndërmerr veprime në kohën e duhur në rastet e paraqitjes së pengesave gjatë realizimit të objektivave të saj.			Nuk është zbatuar. Nuk ishte hartuar strategjia dhe regjistri i rreziqeve.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë që në afat sa më të shkurtë të themeloj dhe funksionalizoj KA-në. Duke emëruar një komitet kompetent të auditimit do të ngritet vlera e auditimit të brendshëm dhe do të sigurohej një funksion i mirëfilltë në zinxhirin e sistemit të kontrolleve të brendshme.	Është zbatuar. Është formuar Komiteti i Auditimit.		
3.1.1 Të hyrat	Ministri duhet të negociojë edhe më tutje me MF-në dhe MAP-in për lejimin e rekrutimit të stafit i cili do të ndihmonte në kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve në kohën e duhur.			Nuk është zbatuar. Përsëri kishte vonesa në regjistrimin e të hyrave deri në tre muaj.
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të negociojë me MF-në, dhe të shikojë mundësitë që të ndahet buxhet për paga konform numrit të aprovuar të punëtorëve, në mënyrë që të krijohet mundësia për hapjen e procedurave të rekrutimit.			Nuk është zbatuar. Edhe këtë vit kishte pozita me Ushtrues Detyre.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të sigurojë se janë shtuar masat e kontrollit, përfshirë edhe numrin e stafit shtesë, në mënyrë që të gjitha regjistrimet në SIMFK të bëhen brenda afatit të përcaktuar kohor.			Nuk është zbatuar. Përsëri kishte vonesa të theksuara në regjistrim.
	Ministri duhet të sigurojë kontrolle efikase në menaxhimin e parasë publike nga MDK-të. Pagesat të realizohen vetëm për mallrat apo shërbimet e përfituara. Në rastet e ndërprerjes se përfitimit të shërbimeve të ndërpriten kontratat.	Është zbatuar.		
	Ministri duhet të sigurojë kontrolle në menaxhimin e parasë së imët nga MDK të. Pagesat duhet të lejohen në përputhje me kornizën ligjore, si dhe të mos tejkalojnë limitet e përcaktuara.			Nuk është zbatuar.

3.1.4 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë, se çdo pagesë të subvencioneve nga kodi buxhetor i MPJ-së i paraprinë një marrëveshje me kushte dhe specifika përkatëse. Po ashtu, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm duhet të sigurojnë se në rastet e mos respektimit të marrëveshjeve nga përfituesit, merren masat e përcaktuara me marrëveshje.			Nuk është zbatuar. Përsëri kemi identifikuar një rast të tillë këtë vit.
3.1.5 Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë se ushtrohen kontrole të mjaftueshme në mënyrë që të shpërblehet me kontratë vetëm OE të cilët i plotësojnë kërkesat në dosjen e tenderit.			Nuk është zbatuar. Edhe këtë vit kemi identifikuar raste të ngjajshme.
3.2 Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë në MPJ pranohen përmes komisionit të pranimit. Në rast nevoje zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme lidhur me rregulloret për menaxhimin e pasurisë.	Është zbatuar. Nuk kemi hasur raste të tilla këtë vit.		
3.3 Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor në mënyrë që të shmanget ekzekutimi i pagesave drejtpërdrejtë nga thesari. Nëse për ndonjë arsye obligimet mbesin të papaguara, ato duhet të raportohen në Thesar.			Nuk është zbatuar. Edhe këtë vit kemi identifikuar fatura të paraportuara si obligime.

Shtojca III: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATI E MARRËDARËS/PODNEZARË: DATE OF RECEIVING/RESPONSE:			
27.06.2018			
Nivëlia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Stranica Br. Stranica No. Pages
03	47	1193	1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO SEKTORI ARCHIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTION			
M. Shkruar Digitally Digitally	1.0	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	1659
M. Shkruar Digitally Digitally	01	Data Date	27.06.2018
Prishtinë / 1/2			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova
Ministry of Foreign Affairs

Nr. Ref. 541/2018

Prishtinë, 25.06.2018

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Behgjet Pacolli

Zëvendëskryeministër i Parë &
Ministër i Punëve të Jashtme